



**VENDIM**

**Nr. 42 Datë 22.04.2011**

**PËR  
MIRATIMIN E “METODOLOGJISË SË LLOGARITJES DHE  
FATURIMIT TË DËMIT EKONOMIK”**

Në mbështetje të neneve 8 gërma “d”, 9 dhe 51 pika “14”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, VKM nr. 338, datë 19.03.2008 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Bordi i Komisionereve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.04.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e CEZ Shperndarje sh.a për miratimin e “Metodologjisë së Llogaritjes dhe Faturimit të Dëmit Ekonomik.”

**Vendosi:**

1. Miratimin e “Metodologjisë së Llogaritjes të Dëmit Ekonomik shkaktuar Kompanisë Shpërndarëse nga çdo ndërhyrje e paligjshme.” (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë CEZ Shperndarje sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



## **METODOLOGJIA E LLOGARITJES SE DEMIT EKONOMIK SHKAKTUAR KOMPANISE SE SHPERNDARJES NGA NDERHYRJET E PALIGJSHME**

(Miratuar me Vendimin Nr. 42 datë 22.04.2011)

### **1. Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Metodologjie është përcaktimi i dëmit ekonomik shkaktuar kompanisë së shpërndarjes nga ndërhyrjet e paligjshme.

### **2. Objekti**

Kjo Metodologji do të jetë e zbatueshme në rastet kur një entiteti të caktuar me ligj i duhet të llogarisë dëm ekonomik të shkaktuar prej ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin elektrik të kompanisë së shpërndarjes.

### **3. Baza Ligjore**

Baza ligjore për hartimin e kësaj metodologjie është Ligji Nr. 9072, date 22.05.2003” Për Sektorin e Energjisë Elektrike“, i ndryshuar, neni 8, pika “d” dhe neni 51, pika “14”.

#### 4. Përcaktimi i Dëmit Ekonomik

Dëmi ekonomik është vlera korresponduese në Leke e sasisë së energjisë elektrike (KWh) të konsumuar mesatarisht gjatë një viti prej një konsumatori/klienti tipik të secilës kategori.

Sasia e energjisë së konsumuar është llogaritur si produkt i konsumit mesatar mujor të një konsumatori/klienti tipik, të kategorisë ku shkaktari i dëmit bën pjesë, me numrin e muajve të një viti (12) dhe përcaktohet në tabelën e mëposhtme:

| <b><u>Kategoritë e Klientëve</u></b>  | <b>Sasia (KWh)</b> |
|---|--------------------|
| <b><u>Kategoria e Pare- Klientë te Vegjël</u></b><br>Matës Mono-faze elektro-metër, | <b>4.000</b>       |
| <b><u>Kategoria e Dytë-Klientë te Mesëm</u></b><br>Matës Tre-Fazore, deri në 30 kW  | <b>10.000</b>      |
| <b><u>Kategoria e Tretë-Klientë te Mëdhenj</u></b><br>Matës Tre –Fazore, mbi 30 kW  | <b>20.000</b>      |

Çmimet që do të aplikohen për këto sasi të llogaritura të dëmit ekonomik do të jenë çmimet e energjisë elektrike të zbatuara në periudhën jashtë pikut, miratuara nga ERE, për kategoritë e klientëve sipas nivelit të tensionit ku ato furnizohen. Për klientët familjarë do të aplikohet çmimi i miratuar për sasinë e energjisë elektrike të konsumuar në bllokun e dytë.

#### 5. Hyrja në Fuqi

Kjo metodologji hyn në fuqi menjëherë.